



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr.	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundi mit të kërkesës	Tarifa
1	15-Jan-2025	<p>- Çfarë të dhënash ka Avokati i Popullit mbi situatën aktuale të urrejtjes dhe diskriminimit anti-mysliman në Shqipëri për periudhën janar 2023 – dhjetor 2024?</p> <p>A ka pasur raste të raportuara tek institucioni juaj gjatë kësaj periudhe, dhe nëse po, sa prej tyre janë adresuar? (dhe cili ka qenë rezultati)</p> <p>A ka pasur çështje që janë transferuar në gjykatë dhe, nëse po, mund të na ofroni më shumë informacion rreth tyre (natyrën e rasteve, rezultatin, reference mbi çështjet në mënyrë që ti kërkojmë gjykatës vendimin e plotë)?</p>	17-Jan-2025	Lidhur me kërkesën tuaj, ju informojmë se institucioni i Avokatit të Popullit nuk disponon aktualisht të dhëna mbi urrejtjen dhe diskriminimin anti-mysliman në Shqipëri për periudhën janar 2023 – dhjetor 2024. Nuk kemi regjistruar raste të raportuara me këtë tematikë gjatë kësaj periudhe dhe, për rrjedhojë, nuk kemi informacion mbi çështje të transferuara në gjykatë apo rezultatet e tyre.	E plotë	Falas
2	13-Jan-2025	<p>-Sa kërcënime ndaj jetës apo lëndime trupore ka pasur ndaj gazetarëve gjatë periudhës 1 janar-31 dhjetor 2024?</p> <ul style="list-style-type: none">• Sa kërcënime të tjera, ngacmime, sulme fizike apo forma të tjera dhune ndaj gazetarëve ka pasur gjatë periudhës 1 janar-31 dhjetor 2024?• A ka pasur raste të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj mediave apo organizatave mediatike për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2024?• Sa raste të sulmeve dhe kërcënimeve online ndaj gazetarëve dhe profesionistëve të tjerë të medias ka pasur gjatë periudhës 1 janar-31 dhjetor 2024?	27-Jan-2025	<p>Në vijim të kërkesës suaj për informacion datë 13.01.2025, ju informojmë se nga Seksioni i Veçantë është ndjekur rasti i gazetarit Elton Qyno dhe është hartuar një draft/raport i veçantë me gjetjet për këtë rast.</p> <p>Avokati i Popullit ka dalë me deklarata publike në media dhe në faqen zyrtare të institucionit në rastet e intimidimeve të gazetarëve.</p> <p>Nga Seksioni i Veçantë në këtë institucion është hetuar administrativisht rasti i gazetarit Elton Qyno. Në rastin e këtij gazetari të medias Ora News, ndonëse në përgjithësi veprimet procedurale nga strukturat e SPAK u kryen në bazë të vendimeve të GJKKO, u vlerësua se gjykata nuk ka marrë asnjë masë për të udhëzuar hetuesit se çfarë duhet të aksesojnë konkretisht.</p>	E plotë	Falas

		<ul style="list-style-type: none"> • A ka pasur gjatë periudhës 1 janar-31 dhjetor 2024 cenim të lirisë së shprehjes të gazetarëve në media? • Gjatë periudhës 1 janar – 31 dhjetor 2024 sa ankesa me subjekt gazetarë apo profesionist të medias kanë ardhur për shqyrtim? • Në rast se ka pasur raportime lidhur me pyetjet e mësipërme do të donim të mësonim se si ju si institucion keni vepruar dhe si ka qenë bashkëpunimi me institucionet e lidhura përgjegjëse? • Cilat kanë qenë rekomandimet që ju si institucion keni sugjeruar ndaj institucioneve përgjegjëse për marrjen e masave të nevojshme për respektimin e të drejtave të gazetarëve dhe profesionistëve të medias? • A keni realizuar raport për vitin 2024 lidhur me të drejtat e gazetarëve dhe nëqoftëse mund të na e vendosni në dispozicion? Cilat janë planet për vitin 2025 lidhur me këtë drejtim. 		<p>Gjykata e ka autorizuar aksesin e SPAK dhe i ka dhënë mundësinë, pa asnjë kufizim, që të sekuestrohen mjetet elektronike të punës së gazetarit, pa bërë një procedurë analize, apo çdo metodë tjetër, për të mbrojtur konfidencialitetin e burimeve gazetareske dhe informacioneve që nuk lidhen me çështjen.</p> <p>Për këto arsye, ekziston një rrezik real që organi i akuzës të ketë akses në aspekte të tjera të punës së ankuesit, që nuk kanë asnjë lidhje me çështjen në fjalë. Ndërkohë, natyrshëm, krijohet dyshimi se në të vërtetë, veçimi vetëm i ankuesit për zbatimin e një mase të tillë dhe dështimi i autoriteteve për të zbatuar masa alternative hetimore, duket se nuk është vetëm për të zbuluar burimin e rrjedhjes së informacionit, por për të ndëshkuar ankuesin për botimin e artikujve, një masë me efekt të dukshëm frikësues/frenues jo vetëm për vetë gazetarin ankues, por të gjithë gazetarët e tjerë në Shqipëri.</p> <p>Ndërkohë, ngrihen edhe dyshime serioze që veprimet e shpejta, disa prej të cilëve pa urdhër gjykate, janë bërë për të kuptuar se deri ku është shtrirë dënimi i gazetarit mbi komunikimet e aplikacionit të enkriptuar SkyECC, ku dyshohet se janë përfshirë një mori personash të botës së krimit, por jo vetëm, duke ngritur dyshime të forta për përfshirjen edhe të personave të lidhur me politikën, biznesin apo median.</p> <p>Izolimi i tij në një nga zyrat e SPAK, duke e mbajtur të mbyllur me çelës për rreth 7 orë përbën intimidim dhe cënim të nenit 27/2 të Kushtetutës, sepse i është kufizuar liria, ndonëse nuk gjendet në asnjë prej rasteve të parashikuara në këtë dispozitë kushtetuese.</p> <p>U vlerësua se nga dokumentacioni i administruar dhe informacioni nuk rezulton që të kishte ndonjë urgjencë për marrjen e këtyre masave ndaj gazetarit Qyno si nga SPAK, ashtu edhe nga GJKKO dhe për më tepër pa e dëgjuar atë, ndonëse ai ndodhej në ambientin e këtyre strukturave. Atij nuk iu dha mundësia e dëgjimit dhe mbrojtjes para gjykatës dhe nuk rezulton që të jetë bërë ndonjë analizë nga këto struktura për të kryer këtë mënyrë gjykimi pa praninë e tij.</p> <p>Këto veprime kanë cenuar garancinë e posaçme për ruajtjen e sekretit profesional lidhur me ruajtjen e burimit të informacionit që gëzojnë gazetarët profesionistë në bazë të nenit 159 KPP.</p> <p>Gjithashtu, ato vijnë ndesh edhe me jurisprudencën e GJEDNJ-së, sipas të cilës sekuestrimi i pajisjeve mund të bëhet vetëm nëse rrethana e paraqet këtë veprim si të domosdoshëm dhe si rruga e vetme e mbërritjes tek e vërteta, kur të gjitha mundësitë e tjera janë ezauruar ose nuk janë efektive. Sekuestrimi duhet të jetë proporcional, pra të shtrihet në sa më pak të dhëna dhe jo të përfshijë një mori pajisjesh, por vetëm të aksesohen aq sa duhen për të arritur marrjen e informacionit pa rrezikuar zbulimin e të dhënave që shpiten te burime të tjerë, gjithmonë kur mbetet opsioni i vetëm i hetimit pas dështimit të të gjitha rrugëve të tjera.</p> <p>Për këtë rast është hartuar Draft/Raporti i Veçantë lidhur me respektimin e të drejtave kushtetuese dhe ligjore, si dhe e standardeve</p>	
--	--	--	--	--	--

				<p>më të larta të të drejtave të njeriut e të palëve në procesin penal, që mund të aksesohet në linkun e mëposhtëm: https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/DRAFT%20per%20KONSULTIM%20PUBLIK%20..%20Raporti_drejtuar_SPAK_etj_per_Elton_Qyno.p</p>		
3	6-Feb-2025	<ol style="list-style-type: none"> 1. A ka marre institucioni juaj ankesa nga organizatat jofitimpruresse dhe grupe informale mbi kufizimin apo ndalimin e tubimeve paqesore gjate vitit 2024? Nese po, sa eshte numri total i ketyre ankesave? Sa prej ketyre ankesave jane adresuar nga institucioni juaj? 2. A ka marre institucioni juaj ankesa nga organizatat jofitimpruresse dhe grupet informale mbi ushtrimin e dhunes nga organet e zbatimit te ligjit gjate organizimit te tubimit? Nese po, sa eshte numri total i ketyre ankesave? Sa prej ketyre ankesave jane adresuar nga institucioni juaj? 3. A ka patur raste te kufizimit te medias te identifikuar nga institucioni juaj gjate organizimit te tubimeve paqesore gjate vitit 2024? Nese po, ju lutem permendi rastet. <p>A ka marre institucioni juaj ankesa nga organizatat jofitimpruresse grupeve informale mbi survejimin te mjeteve online te komunikimit (media sociale, faqe interneti, email, etj) nga autoritetet shteterore? Nese po, sa eshte numri total i ketyre ankesave? Sa prej ketyre ankesave jane adresuar nga institucioni juaj?</p>	20-Feb-2025	<p>Gjtaë vitit 2024, në Institucionin e Avokatit të Popullit nuk janë regjistruar ankesa nga organizatat jofitimprurëse, që kanë të bëjnë me tubimet apo me survejimin e mjeteve të komunikimit online, nga autoritetet shtetërore.</p> <p>Ndërkohë, Avokati i Popullit, pasi është njohur me njoftimin nga subjektet politike opozitare, për zhvillimin e protestave, referuar nenit 13, paragrafi i parë, të Ligjit nr.8485, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, në të cilin parashikohet se: “Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike”, gjatë vitit 2024, ka ngritur grupe pune, të cilat kanë monitoruar në terren dhe në media, 5 (pesë) protestat e organizuar nga këto subjekte politike, në kuadër të të drejtës për tubime paqësore. Krahas monitorimit, Institucioni Avokatit të Popullit, ka zhvilluar edhe verifikime pas protestës në komisaritet e policisë së Tiranës, lidhur me respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar. Protestat kanë qenë paqësore, përveç ndonjë rasti sporadik, kur janë hedhur kapsolla plasëse dhe tymuese në drejtëm të punonjësve të Policisë së Shtetit.</p> <p>Protestuesit janë mbledhur në pika të ndryshme të kryeqytetit, ku kanë bllokuar qarkullimin e automjeteve.</p> <p>Protestuesit janë shpërndarë në mënyrë paqësore, në orarin e njoftuar nga organizuesit, për mbylljen e protestës.</p> <p>Nga verifikimet e kryera në komisaritet e policisë është konstatuar sa më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Personat e shoqëruar qëndronin në kushte mbipopullimi, kryesisht në Komisaritetin e Policisë Nr.1, Tiranë. - Ka patur zvarritje të procedurave për personat e shoqëruar, për arsye se oficerët e policisë gjyqësore që do të intervistonin të shoqëruarit dhe do të këqyrnin provat, ndodheshin në terren dhe pritej kthimi i tyre për të vijuar procedurat. - Disa të shoqëruar nuk janë njohur me kartën e të drejtave. - Nga ana e të shoqëruarve janë paraqitur vetëm 4 pretendime për keqtrajtim. - Disa shtetas të shoqëruar kanë pretenduar se janë ndaluar nga punonjës të policisë të veshur civilë dhe pa mjet identifikimi. - Pjesa më e madhe e të shoqëruarve është liruar pas verifikimeve. <p>Arsyeja e shoqërimit sipas shënimeve në regjistrin përkatës ka qenë për “pjesëmarrje në protestë për bllokim ruge”.</p>	E plotë	Falas

				Për sa i përket mbipopullimit në dhomat e shoqërimit dhe të drejtave të personave të shoqëruar, janë adresuar rekomandimet përkatëse, të cilat i gjeni në faqen tonë zyrtare, në rubrikën e botimit të raporteve vjetore. Ndërsa, për sa i përket pretendimeve për keqtrajtim, në përfundim të hetimit tonë administrativ, këto pretendime nuk janë provuar dhe nuk ka lindur nevoja për të hartuar rekomandime.		
4	3-Mar-2025	<p>-Sa ceshtje ka shqyrtuar institucioni i Avokatit te Popullit pergjate vitit 2024 dhe cili eshte statusi i tyre aktual?</p> <p>- Pergjate vitit 2024 keni patur ceshtje te cilat Avokati i Popullit ka iniciuar hetimin administrativ kryesisht?</p> <p>- Sa rekomandime ka leshuar institucioni juaj pergjate vitit 2024?</p> <p>- Ne ceshtjet e trajtuara nga institucioni juaj pergjate vitit 2024, jane shqyrtuar te gjitha dosjet brenda afateve te parashikuara me ligj? Nese jo, ju lutem mund te informoni ceshtjen(t) trajtuar me kohezgjatje per te afateve ligjore (perfshire edhe ato per te cilat mund te jete proceduar me vendim per zgjate afati kohor) dhe shkaqet per sa me lart?</p> <p>- Gjithashtu, ju lutem mund te ndani raportin financiar te institucionit ne lidhje me alokimin dhe egzekutimin e buxhetit ne vitin 2024?</p>	7-Mar-2025	<p>Në lidhje me pyetjet nr.1, nr.2 sa i përket numrit të çështjeve të shqyrtuara gjatë vitit 2024, dhe atyre të iniciuara kryesisht, ju informojmë se ky informacion nuk disponohet ende i përpunuar në formën e kërkuar. Ai do të jetë pjesë e raportit vjetor të institucionit të Avokatit të Popullit, i cili është aktualisht në fazën e përgatitjes, në përputhje me nenin 26 të ligjit nr. 8454/1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar.</p> <p>Në lidhje me pyetjen 3, ju informojmë se gjatë vitit 2024 janë leshuar gjithsej 300 rekomandime.</p> <p>Në lidhje me pyetjen 4, sa i përket afateve të hetimeve administrative, ju informojmë se ky informacion nuk disponohet në formën e kërkuar nga ana juaj. Të dhënat e mbledhura dhe të administruara nga institucioni ynë janë të organizuara në bazë të rasteve konkrete dhe problematikave të trajtuara, por jo të kategorizuara sipas afateve mesatare ose maksimale të përfundimit të hetimeve administrative, shtyrjeve të afateve përkatëse apo arsyeve/shkaqeve të shtyrjes së tyre.</p> <p>Në lidhje me pyetjen 5, raportin financiar të institucionit do ta gjeni në linkun e mëposhtëm: https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Raport%20monitorimi%20%20viti%202024%20w.pdf</p>	E plotë	Falas
5	9-Mar-2025	<p>Sa eshte numri i ankseave te qytetarëve per shkelje te te drejtave te njeriut ne vitin 2024 per keto institucione:</p> <p>-Ministria e Shëndetësisë</p> <p>-Ministria e Drejtësisë</p> <p>-Sistemi gjyqësor(Gjykata dhe Prokurori)</p> <p>-Ministria e Brendshme</p>	12-Mar-2025	<p>Pasi jemi njohur me kërkesën tuaj për informacion lidhur me ankesat e qytetarëve për shkelje të të drejtave të njeriut në vitin 2024 sipas institucioneve.</p> <p>Ju informojmë se ky informacion nuk disponohet ende i përpunuar në formën e kërkuar. Ai do të jetë pjesë e raportit vjetor të institucionit të Avokatit të Popullit, i cili është aktualisht në fazën e përgatitjes, në përputhje me nenin 26 të ligjit nr. 8454/1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar. Raporti vjetor i Avokatit te Popullit do të bëhet publik në faqen zyrtare të institucionit www.avokatipopullit.gov.al, në rubrikën "Botimet" > "Raporte vjetore". link: https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/list/publications/rraporte-vjetore-2/.</p>	E plotë	Falas
6	11-Mar-2025	<p>1. A e monitoroni trajtimin e personave me probleme të shëndetit mendor në institucionet përkatëse?</p> <p>2. A monitoroni trajtimin e personave me probleme të shëndetit mendor në konflikt me ligjin?</p>	17-Mar-2025	<p>Lidhur me kërkesën tuaj për informacion ju parashtrijmë si më poshtë:Niveli i respektimit të të drejtave të personave në Spitalet Psikiatrike</p>	E plotë	Falas

		<p>3. Cilat janë shqetësimet kryesore të hasura në lidhje me trajtimin e tyre në institucionet penale dhe psikiatrike?</p> <p>4. A ofroni mbështetje juridike për këta individë dhe familjet e tyre?</p> <p>5. A ka patur pretendime të trajtimit në kundërshtim me të drejtat e njerit apo përdorimit të forcës ekseseive në 5 vitet e fundit?</p> <p>6. Po denoncime?</p> <p>7. Në vlerësimin tuaj, sa dinjitoz është trajtimi i personave me çrregullime të shëndetit mendor në të gjitha hallkat institucionale në Shqipëri?</p> <p>8. Po përsa i përket grupeve vulnerabël siç janë vajzat, gratë dhe të miturit dhe grupet e marginalizuara?</p> <p>9. Përsa më sipër, në cilat aspekte do të vlerësonit se ka nevojë për ndërhyrje dhe përmirësim?</p>		<p>Mekanizmi Kombëtar ka inspektuar institucionet e shëndetit mendor si Spitali Psikiatrik Vlorë, Spitali Psikiatrik Shkodër, Spitali Psikiatrik Elbasan, I EVP Lezhë, Instituti i Veçantë Shëndetësor i të Burgosurve (IVSHB) dhe Spitali Psikiatrik “Xhavit Gjata” Tiranë.</p> <p>Nga këto inspektime, problematikat kryesore të konstatuara janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ mungesa e kushteve strukturore të përshtatshme për trajtimin dhe rikuperimin e të sëmurëve në Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinçi” në Elbasan, Spitalin Psikiatrik “Xhavid Gjata” në Tiranë dhe Spitalin me shtretër në Shkodër; ▪ mungesa e aktiviteteve rikuperuese apo ambienteve të zhvillimit të aftësive okupacionale në Spitalin Psikiatrik “Xhavid Gjata” në Tiranë, Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinçi” në Elbasan dhe Spitalin me shtretër në Shkodër; ▪ numër i pamjaftueshëm i kapaciteteve për të akomoduar personat në fazë rikuperimi, ▪ konstatimi i përsëritur për mungesën e investimeve dhe rikonstruksionit të plotë të godinës së Spitalit Psikiatrik “Sadik Dinçi”, në Elbasan, rekomandim i përsëritur ndër vite nga Avokati i Popullit si dhe të Spitalit Psikiatrik Xhavit Gjata Tiranë. ▪ shtimin në organikat e spitaleve të mjekëve psikiatër, infermierëve “kujdestarë/task forcë”, stafit të sigurisë, sanitarëve dhe berberit, me qëllim ofrimin e një shërbimi të përshtatshëm për specifikat e këtij shërbimi të shëndetit mendor me shtretër. Avokati i Popullit vazhdon të vlerësojë se është i nevojshëm shtimi i menjëhershëm dhe në vitet në vijim i kuotave për specializantë në Psikiatri; riformulimi i kriterëve të punësimit për funksionet klinike “kujdestar” dhe “task forcë”, me edukim infermieristik dhe njohuri të thelluara në rehabilitim psikiatrik spitalor, si dhe me aftësi moshore e fizike të përshtatshme për menaxhimin e axhitimit dhe riskut të lartë si dhe trajnimin e punonjësve aktualë; ▪ vendosjen e sistemit monitorues me kamera vëzhgimi në ambientet e përbashkëta të spitaleve psikiatrike; ▪ krijimin/rikonstruksionin e plotë të dhomave të izolimit, duke i kompletuar ato në përputhje me pikën 4.6 “Infrastruktura e Izolimit”, të “Standardeve të Kufizimit 	
--	--	---	--	--	--

				<p>Fizik në Shërbimet e Shëndetit Mendor të Specializuar me Shtretër”;</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ pajisjen e spitaleve me mjete të kufizimit mekanik; ▪ mundësimin e riorganizimit të pavijoneve të pacienteve akutë më vete; ▪ kushte infrastrukturore në pavijone, ngrohje, dushe dhe tualete në mënyrë që të ofrohet një shërbim sa më dinjitoz të personave që trajtohen në spitalet psikiatrike, si dhe sigurimin e bazës së nevojshme materiale për stafet psiko-sociale. ▪ mungesa në trajnimin e stafeve mbështetëse për përdorimin e mjeteve fizik konform standardeve të parashikuara në paketën e Akteve Nënligjore të ligjit Nr. 44/2012 ”Për Shëndetin Mendor”, dhjetor 2013 pika 1.1. si dhe përmirësimin e kushteve aktuale për izolimin e pacientëve me kriza akute. ▪ mungesa në medikamente si dhe marrja e furnizimit të plotë me medikamente të parashikuar nga Spitalet Psikiatrike sipas nevojave. ▪ Mungesa në pajisje me shtretër dhe dyshekë të rinj për të gjitha dhomat në Shërbimin e Shëndetit Mendor me Shtretër Shkodër. ▪ Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për sigurimin e pajisjeve në kabinetin stomatologjik brenda vitit 2024. ▪ Mungesa të Laboratorëve klinik bio-kimik, si dhe sigurimi i pajisjeve për kabinetet stomatologjik. <p>Institucioni i Avokatit të Popullit thekson se është e nevojshme që në vazhdimësi të ketë një koordinim brenda strukturave nga të cilat drejtohen shërbimet e psikiatrisë dhe të ketë një angazhim lidhur me analizimin me përgjegjësi dhe zbatimin e rekomandimeve, si dhe rritjen e bashkëpunimit me Institucionin e Avokatit të Popullit, Avokati i Popullit ndër vite ka ngritur shqetësimin se kushtet e jetesës në të cilat janë të akomoduar pacientët me çrregullime të shëndetit mendor në Shqipëri vazhdojnë të jenë të rënda dhe të papranueshme. Ka një nevojë emergjente në fillimin pa vonesa të rikonstruksionit të Spitalit Psikiatrik “Xhavid Gjata” në Tiranë dhe Spitalit Psikiatrik “Sadik Dinçi” në Elbasan. Kushtet infrastrukturore luajnë rol të rëndësishëm për mirëqenien e të sëmurëve me çrregullime të shëndetit mendor dhe gjejmë rastin të shprehim vlerësimin për fillimin e proceduarve për rikonstruksionin e Godinave të Spitalit Psikiatrik Tiranë dhe Elbasan,</p>		
--	--	--	--	--	--	--

			<p>me realizimin e projekteve përgjatë vitit 2024, proces që duhet të vazhdojë për dhënien e zgjidhjes përfundimtare të këtyre problematikave. Avokati i Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar, ka tërhequr në mënyrë të përsëritur vëmendjen e institucioneve qëndrore, për ngritjen sa më parë të Institucionit të Posaçëm Mjekësor në varësinë e MSHMS-së, pasi kushtet e trajtimit në IEVP Lezhë, Spitalin e Burgjeve dhe SKV në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, ku janë të akomoduar aktualisht personat me çrregullime të shëndetit mendor, nuk plotësojnë kushtet minimale për trajtimin e tyre mjekësor dhe rehabilitimin shëndetësor të tyre.</p> <p>https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20Lezhe%202024.pdf</p> <p>/avokatipopullit.gov.al/sq/articles/mechanisms-against-torture/psychiatric-hospitals/rekomandime-mbi-spitalet-psikiatrike-2023-979/ Po përsa i përket grupeve vulnerabël siç janë vajzat, gratë dhe të miturit dhe grupet e marginalizuara? Avokati i Popullit i ka rekomanduar Ministrin të Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve në mënyrë të përsëritur për mbylljen e IEVP 325 “Ali Demi”, në vitin 2024 në bazë të Urdhrit të Ministrin të Drejtësisë nr.351, datë 27.06.2024, u parashikua se “Për klasifikimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, i ndryshuar parashikon në pikën “24/1 u krijua institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Pojskë, Pogradec i cili klasifikohet burg për gra, me një seksion siguri e lartë, me një seksion siguri e zakonshme, me një seksion siguri e ulët dhe një seksion paraburgimi. Avokati i Popullit, vlerëson hapjen e këtij institucioni bashkëkohor, i cili është në përputhje me rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe Komitetit për Parandalimin e Torturës ndër vite. Qëllimi kryesor i sistemit penitenciar është riedukimi i personave në konflikt me ligjin, duke u ofruar atyre mundësi për një jetë të re dhe më të mirë pas përfundimit të dënimit.</p> <p>avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/11.11.2024%20Ojske.pdf.</p> <p>Avokati i Popullit në mënyrë periodike ka inspektuar IEVP Kavajë ku akomodohen të Miturit në Konflikt me Ligjin Qëllimi i inspektimeve është vlerësimi i kushteve të Institutit të të Miturve në Kavajë, garantimi i sigurisë, jetës, shëndetit dhe krijimi i ambienteve rekreative me qëllim rehabilitimin dhe ri-integrimin e personave që vuajnë dënimin, trajtimi dhe respektimi i të drejtave të të miturve të përcaktuara në aktet ligjore, nënligjore dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim, si</p>	
--	--	--	---	--

				<p>dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.</p> <p>Sa më sipër kemi rekomanduar: 1.Marrjen e masave të nevojshme, për plotësimin e organikës të stafit mjekësor me një mjek të përgjithshëm me kohë të plotë dhe një infermier sipas organikës së miratuar, me qëllim garantimin cilësor të shërbimit shëndetësor për të burgosurit. 2.Marrjen e masave për angazhimin e mjekut në bashkëpunim me stafin psiko-social duke vepruar si një ekip multidisiplinar për organizimin e një karteletë të përbashkët për të miturin e burgosur për të bërë të mundur një rishikim të rregullt të gjendjes së shëndetit fizik dhe atij mendor nga mjeku psikiatër. 3.Marrjen e masave, për pajisjen e institucionit me një autoambulancë për rastet emergjente të të sëmurëve dhe shoqërimin në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë. 4.Marrjen e masave për vendosjen e kamerave në ambientet që frekuentohen nga të miturit që të kryhet mbikëqyrja me kamera e të gjithë mjediseve në IEVP me qëllim parandalimin e veprime të kundërligjshme, përveç atyre mjediseve ku çenohet privatësia. 5.Marrjen e masave të menjëhershme, për plotësimin e organikës në sektorin e policisë, për 10 (dhjetë) pozicionet vakant të specialistëve të rolit bazë, që ndikojnë në nivelin e gatishmërisë dhe të sigurisë të të miturve që vuajnë dënimin në këtë institucion. 6.Marrjen e masave nga Institutin e të Miturve Kavajë, për përcaktimin në çdo sektor të një ambienti/zone për pirjen e duhanit, në mënyrë që të miturit e tjerë të burgosur të mos dëmtohen nga pirja pasive e duhanit. 7.Marrjen e masave për punësimin e një instruktori të punës me dru për organizimin e kursit të formimit profesional të punës me dru. 8.Marrjen e masave për hapjen e programeve të reja të kurseve të formimit profesionale për kamarier dhe kuzhinier. 9.Marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për të rritur numrin e orëve të ngrohjes në 10 orë sipas përshtatjes dhe me kushtet klimaterike të zonës nga 6 orë që është aktualisht.</p> <p>www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Miturit%20kavaje%202024.pdf.</p>		
7	9- Mar-2025	<p>A ka patur një rritje të rasteve të dhunës ndaj grave në 5 vitet e fundit? Ju lutem specifikoni shifrat për secilin vit.</p> <p>2. Sa raste denoncimesh për dhunë ndaj vajzave dhe grave ka patur në 5 vitet e fundit?</p> <p>3. Për sa më sipër, specifikoni llojet e dhunës së ushtruar?</p> <p>4. Sa përqind e këtyre denoncimeve tërhiqen nga denoncueset?</p>	20-Mar-2025	<p>Lënda: Jepet informacion, kërkuar në kuadër të së drejtës për informim lidhur me rastet e dhunës me bazë gjinore dhe krimeve, në 5 vitet e fundit.</p> <p>Institucioni i Avokatit të Popullit, është institucioni më i lartë kombëtar kushtetues për promovimin, parandalimin e shkeljeve dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike.</p> <p>Në këtë kontekst edhe adresimi i shkeljeve të të drejtave dhe interesave të tjera të ligjshme të grave dhe vajzave, si pjesë e pandashme e të drejtave të njeriut, është pjesë e prioriteteve strategjike të Avokatit të Popullit.</p>	E plotë	Falas

		<p>5. Cilat janë masat e arrestit që jepen më së shumti për të akuzuarit për dhunë dhe krime ndaj grave? - Cilat rrethana merren parasysh?</p> <p>6. Sa zgjasin mesatarisht hetimet?</p> <p>7. Sa urdhra mbrojtjeje janë kërkuar dhe lëshuar për raste të dhunës ndaj grave? Për çfarë lloj dhune kërkohen ato?</p> <p>8. Cilat janë përfitimet efektive të urdhërit të mbrojtjes?</p> <p>9. Sa vajza dhe gra janë vrarë nga partneri ose ish partneri në 5 vitet e fundit? Ju lutem specifikoni shifrat për secilin vit.</p> <p>10. Cilat janë dënimet më të shpeshta të dhëna për raste të krimeve ndaj vajzave dhe grave?</p> <p>11. Cilat janë nismat që janë ndërmarrë për të adresuar këto problematika? - Në bashkëpunim me cilat instanca publike, jopublike, brenda dhe jashtë vendit?</p> <p>12. Sa të qëndrueshme janë këto iniciativa?</p> <p>13. Për sa më sipër, specifikoni cilat qytete, cilat grupmosha dhe grupe specifike janë më të prekura nga rastet e dhunës dhe krimet ndaj grave?</p> <p>14. Sa raste recidivizmi të krimeve ndaj grave ka patur në 5 vitet e fundit? - Cilat janë krimet më të shpeshta të recidivizmit?</p> <p>15. A i siguron shteti avokat grave të cilat denoncojnë agresorët? Në optikën tuaj, a përfaqësohen ato në mënyrë dinjitoze nga keta avokatë?</p> <p>16. Sipas raportimeve të Avokatit të Popullit, a i sigurohet grave dhe vajzave jetesa dinjitoze, në përputhje me të drejtat e njeriut, në vendin tonë?</p> <p>17. Cilat kanë qenë problematikat e evidentuara dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit, për sa më sipër?</p> <p>18. Në 5 vitet e fundit, sa raste të krimeve të kryera nga gratë vijnë si pasojë e dhunës sistematike të përjetuar prej tyre? - Si faktorizohet kjo rrethanë në masat e dënimeve të dhëna për to?</p>		<p>Çështjet e dhunës ndaj grave dhe vajzave apo të dhunës në familje, trajtohen si nëpërmjet ankesave ashtu dhe nëpërmjet rasteve të ndërmarrura nga institucioni me iniciativë.</p> <p>Lidhur me të dhënat specifike të kërkuara lidhur me dhunën ndaj grave dhe vajzave dhe pyetje të tjera të adresuara, duam t'ju sqarojmë se Institucioni i Avokatit të Popullit në kuadër të tagrit të tij monitorues, mund të kërkojë të dhëna të tilla me qëllim përgatitjen e raporteve tematike dhe rekomandimeve, nga institucionet ekzekutive si Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Drejtësisë apo institucione të tjera të ngarkuara nga ligji, të cilat kanë detyrimin ligjor për mbajtjen e statistikave.</p> <p><i>Më poshtë gjeni disa të dhëna, burimi zyrtar i së cilave janë raporte të ndryshme të shtetit dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.</i></p> <p>Në vitin 2021, u evidentuan dhe u trajtuan 5312 raste të dhunës në marrëdhëniet familjare, nga të cilat 3266 raste u trajtuan me kërkesë-padi “Për lëshimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes/Urdhrit të Mbrojtjes”. Të ndara sipas gjinise, të dëmtuar nga dhuna në familje kanë qënë 3960 gra/vajza. Sipas nenit 130/a “Dhuna në familje” ka filluar procedimi penal për 1631 raste dhe janë arrestuar 638 autorë.</p> <p>Në vitin 2022 u evidentuan dhe u trajtuan 5210 raste të dhunës dhe krimeve të tjera të ndodhura në marrëdhëniet familjare, nga të cilat 2940 raste u trajtuan me kërkesë-padi “Për lëshimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes/Urdhrit të Mbrojtjes”. Të dëmtuara nga dhuna në marrëdhëniet familjare kanë qënë 3767 gra/vajza, ose rreth 72 % e numrit total të viktimave të dhunës. Sipas nenit 130/a “Dhuna në familje” ka filluar procedimi penal për 1887 raste dhe janë arrestuar 682 autorë.</p> <p>Në vitin 2023 u evidentuan dhe u trajtuan 5064 raste të dhunës dhe krimeve të tjera të ndodhura në marrëdhëniet familjare, nga të cilat 2730 raste u trajtuan me kërkesë-padi “Për lëshimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes/Urdhrit të Mbrojtjes”. Të dëmtuara nga dhuna në marrëdhëniet familjare kanë qënë 3649 gra/vajza, ose rreth 67.6 % të numrit total të viktimave të dhunës. Sipas nenit 130/a “Dhuna në familje” ka filluar procedimi penal për 1911 raste dhe janë arrestuar 699 autorë.</p> <p>Për periudhën janar–shtator 2024 janë evidentuar dhe trajtuar 4145 raste të dhunës dhe krimeve të tjera të ndodhura në marrëdhëniet familjare, rezulton se ka patur 318 raportime me shumë se gjatë së njëjtës periudhë të vitit 2023. Janë trajtuar me kërkesë-padi “Për lëshimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes/Urdhrit të Mbrojtjes”, 2226 raste të dhunës në familje, 171 raste (rreth 7.6 %) më shumë se gjatë së njëjtës periudhë të vitit 2023. Të dëmtuara nga dhuna në marrëdhëniet familjare kanë qënë 2923 gra/vajza, ose rreth 68.7% të numrit total të viktimave të dhunës.</p>		
--	--	--	--	---	--	--

			<p>Janë evidentuar 138 raste të shkeljeve të Urdhrave të Mbrojtjes, rreth 11.1% më shumë se gjatë së njëjtës periudhë të vitit 2023. Ka filluar procedimi penal për 1606 raste dhe janë arrestuar 654 autorë, ndaluar 71 autorë.</p> <p>Gjatë periudhës së pandemisë bazuar në raportet e përgatitura nga organizatat e shoqërisë civile, por edhe të dhënat e Policisë së Shtetit, rezultojnë se numri i rasteve të raportimeve në komisariatet e policisë ka qënë më i ulët krahasimisht me vitin para fillimit të pandemisë. Kjo rënie lidhet kryesisht me situatën e vështirë me të cilën po përballon vendi, fokusimi i strukturave shtetërore tek menaxhimi i situatës së pandemisë, vështirësia për të aksesuar institucionet (frika, pasiguria, mungesa e besimit) etj. Rënia e numrit të denoncimeve u reflektua edhe në rënien e numrit të çështjeve me objekt lëshimin e Urdhërimit të Mbrojtjes të shqyrtuara nga gjykatat. Rënia e numrit të denoncimeve është vënë re sidomos gjatë periudhës së karantinës kur në vend pati masa të rrepta izolimi (periudha Mars-Maj 2020). Megjithatë gjatë kësaj periudhe pati shtim të numrit të raportimeve pranë Linjës Kombëtare të Këshillimit për Gra dhe Vajza 116- 117, të cilat gati u trefishuan me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës.</p> <p>Pra nëse shohim shifrat duket qartë që përafërsisht 70% e rasteve të dëmtuara nga dhuna në marrëdhëniet familjare janë gratë.</p> <p><u>Avokati i Popullit bashkëpunon me INSTAT për përgatitjen e Seksionit Të drejtat e Njeriut të botimit të përvitshëm “Burra dhe gra në Shqipëri”.</u></p> <p>Në vitin 2020, u nënshkrua : "Memorandumi i Mirëkuptimit midis Avokatit të Popullit dhe Institutit të Statistikave "Për bashkëpunimin në fuqizimin e mbledhjes së të dhënave, përhapjen dhe analizën në dritën e të drejtave të njeriut dhe Agjendës së Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030"</p> <p>Në zbatim të këtij memorandumi, Institucioni i Avokatit të Popullit ofroi kontributin e vet, që u përfshi në publikimin “Burrat dhe Gratë në Shqipëri 2021”.¹ Ky është një publikim me periodicitet vjetor, që paraqet të dhëna në fusha të ndryshme të jetës të ndara sipas gjinisë, me qëllim reflektimin e problematikave të shoqërisë në kuadër të arritjes së barazisë gjinore, në të cilën është përfshirë dhe një kapitull me tregues mbi të drejtat e njeriut. Statistikat mbi të drejtat e njeriut pasqyrojnë të dhëna sipas gjinisë mbi ankesat për pretendime shkeljeje të të drejtave, të trajtuar nga Avokati i Popullit, sipas llojit të së drejtës. Për të dhëna të detajuara referojmë botimit “Burra dhe gra 2021”², “Burra dhe gra 2022”³ “Burra dhe gra 2023”⁴. Psh: në botimin më të fundit nga INSTAT rezultojnë se: ankesa të paraqitura nga burrat për pretendim shkeljeje të të drejtave sipas llojit janë 843 ankesa (52,2 %) dhe 472 ankesa janë paraqitur nga gratë (29,3 %). Ankesa për shkeljeje për grupe të ndryshme interesi ku përfitojnë të dyja gjinitë, për vitin 2022 janë 229 (18,5 %). Në totalin e ankesave për pretendim shkeljeje</p>	
--	--	--	--	--

			<p>të së drejtave, shumica e tyre i përkasin të drejtave në grupin e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore.</p> <p><u>Të dhënat për femicidet.Observatori për femicidet</u></p> <p>Avokati i Popullit ka ngritur pranë tij Observatorin për femicidet, prej marsit 2024.</p> <p>Observatori për Femicidet është një mekanizëm monitorimi lidhur me vrasjet e grave/vajzave, me qëllim parandalimin e këtij fenomeni dhe fuqizimin e mekanizmave për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të dhunës gra dhe vajza.</p> <p>Ngritja e Observatorit për Femicidet përbën një hap të rëndësishëm në drejtëm të institucionalizimit të përpjekjeve për parandalimin e këtij fenomeni dhe për rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të strukturave përgjegjëse në drejtëm të trajtimit dhe adresimit të çështjeve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.</p> <p>Shqipëria është vendi i parë në Ballkan dhe ndër të paktat vende në Europë që ka ngritur Observatorin për Femicidet, duke hedhur një hap tepër të rëndësishëm në drejtëm të zbatimit të detyrimeve që burojnë nga ratifikimi i instrumentave ndërkombëtare që në përmbajtjen e tyre kanë mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.</p> <p>Bazuar në analizimin e të dhënave të mbledhura gjatë vitit 2024 në kuadër të Observatorit, Avokati i Popullit ka hartuar një Raport mbi vrasjet e grave dhe vajzave për periudhën 2021-2023⁵. Ky raport u prezantua në konferencën vjetore të Avokatit të Popullit të mbajtur me datën 10 Dhjetor 2024, ditën Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut.</p> <p>Sipas këtij raporti gjatë viteve 2021-2023, në Shqipëri u vranë 32 gra dhe vajza, 27 prej të cilave u vranë nga autorë me të cilët viktimat ishin në marrëdhënie familjare. Nga 28 autorët e vrasjeve, 26 ishin burra dhe djem dhe në dy raste autore ishin një grua dhe një vajzë. Në 28 raste autori është gjetur dhe në dy raste autori nuk është gjetur nga organet kompetente. Gjashtë autorë humbën jetën menjëherë pas ngjarjes, nga të cilët pesë u vetëvranë dhe një humbi jetën në përpjekje për t'iu shmangur arrestimit nga policia. Dy autorë humbën jetën në paraburgim gjatë hetimeve.</p> <p>Rezulton se nga 32 rastet e vrasjeve të grave dhe vajzave, 24 u vlerësuan si femicide, ose vrasje për shkak të gjinisë bazuar në kuadrin statistikor të OKB.</p> <p>Rezulton se në rreth 90% të rasteve viktimat dhunoheshin nga autorët e vrasjes përpara kryerjes së krimit, por vetëm 6 prej tyre (25%) e kishin raportuar më parë në polici dhunën, dy prej këtyre rasteve ishin të pajisura me masa mbrojtëse (UMM/UM) në momentin e vrasjes, asnjë prej rasteve nuk ishte pajisur me Urdhërin për masat paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme.</p> <p>Në raport do të gjeni të dhëna më të hollësishme.</p> <p>Disa nga problematika e evidentuar 5 vitet e fundit nga AP lidhur me të drejtat e grave janë adresuar edhe në raportet e veçanta të tij</p>	
--	--	--	---	--

			<p>si dhe në raportet vjetore. (për hollësi referojuni raporteve në faqen zyrtare të AP)</p> <ul style="list-style-type: none"> -Hartimi i një kuadri ligjor, që adreson në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha format e dhunës me bazë gjinore – krahas dhunës në familje - si ngacmimi dhe dhuna seksuale, përndjekja, martesat e detyrueshme, etj. -Ndryshime ligjore/nënligjore për të siguruar mënyra alternative për zbatimin e detyrimeve ligjore, që për momentin janë të pamundura për shkak të mungesës së disa shërbimeve, si për shembull detyrimi që ka gjykata të urdhërojë dhunuesit të ndjekin programe rehabilitimi, të cilat në praktikë nuk ekzistojnë në pjesën më të madhe të vendit. -Ndryshimi i përkufizimit të veprës penale të marrëdhënieve seksuale me dhunë në Kodin Penal (si për madhorët ashtu edhe të miturit), në përputhje me Konventën e Stambollit. -Ndryshime në Kodin Penal në drejtim të përkufizimit të masave ndëshkuese në lidhje me martesat e detyrueshme, si dhe përfshirjen si vepra penale të sterilizimit të detyrueshëm dhe gjymtimit gjenital, të dy këto, krime me natyrë seksuale të parashikuara si të tilla nga Konventa e Stambollit. -Marrjen e masave për zbatimin me efektivitet të legjislacionit të përmirësuar. -Ndryshimi i ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, për të mundësuar aksesin paralel të viktimave të dhunës dhe përfitueseve të ndihmës ekonomike. -Ndryshim të legjislacionit për të evidentuar zbatimin efektiv të programeve rehabilituese për dhunuesit. -Nevojën për një koordinim më të mirë të Mekanizmave të Referimit të Dhunës në nivel lokal me strukturat e policisë për të referuar në mënyrë të ndërsjelltë rastet e dhunës në familje dhe formave të tjera dhe për t’u ofruar viktimave të gjitha shërbimet e nevojshme. -Nevojën për përsheptimin e masave përfshi edhe ato financiare për ngritjen e qendrave të tjera rajonale me shërbime mbështetëse të specializuara për viktimat e dhunës seksuale dhe qendrave afatgjata për rikuperimin e traumës për viktimat e dhunës seksuale dhe trafikimit për qëllime të shfrytëzimit seksual, përfshirë dhe viktimat/ të mbijetuarat me çrregullime të shëndetit mendor, pavarësisht kohës së sulmit të pësuar të këtyre qendrave. -Ngritja e shërbimeve për rehabilitimin e dhunuesve. -Rritjes së aksesit të grave në të drejtat pronësore.⁶ - Dhuna seksuale ndaj grave dhe vajzave minorene, e raportuar më shpesh nga mediat, përbën një problem shqetësues, gjë e cila ka treguar se insitucionet përgjegjëse duhet të shtojnë vëmendjen ndaj kësaj problematike. -Problematikat e ngacmimit seksual në ambientet publike dhe bullizmi nëpërmjet platformave sociale kanë pësuar një rritje të dukshme. 		
--	--	--	---	--	--

			<p>Fyerjet, shpifjet, gjuha e urrejtjes e përdorur në disa raste kanë shkaktuar situata dhune në familje deri tentativa për vetëvrasje të grave.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi i gjuhës seksiste në mediat audiovizive.⁷ -Vrasja ndaj grave dhe vajzave/ femicidi është një nga format më ekstreme të dhunës. -Problemet e shëndetit mendor me të cilën përballlet sot shoqëria, bëhen më të rënda në rastet e dhunës në familje, ku vazhdon të konstatohet vështirësi në menaxhimin e rasteve të tilla nga shërbimet sociale në bashkitë e vendit. <p><u>Lidhur me problematikat, trajtimin e tyre, rekomandimet dhe analizat/raporte te veçanta dhe informacione për aktivitete lidhur me dhunën me</u> bazë gjinore dhe dhunën në familje ju lutem referojuni seksionit përkatës “Të drejtat e grave”, të Raporteve Vjetore të Avokatit të Popullit, për vitet 2020-2024, të cilat mund t’i aksesoni në linkun: https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/list/publications/rraporte-vjetore-2/?page=2</p> <p><u>Raporte të veçanta:</u></p> <p>Në kuadër të vlerësimit të punës së institucionit të Avokatit të Popullit, nëpërmjet rezolutës së Kuvendit të miratuar më 07.07.2021, Kuvendi i Shqipërisë i ka kërkuar Avokatit të Popullit të përcjellë një raport të detajuar për çështjet e dhunës në familje.</p> <p>Për këtë qëllim është hartuar dhe dorëzuar në Kuvend <u>raporti “Mbi situatën e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në Shqipëri për periudhën Janar 2020-Shtator 2021”</u>, i cili jep informacion jo vetëm mbi situatën e dhunës në marrëdhëniet familjare por trajton edhe çështje që kanë të bëjnë edhe me format e tjera të dhunës ndaj grave, duke qenë se janë të ndërlydhura.</p> <p>Raportin e gjeni në web e Avokatit të Popullit , në linkun: https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/list/publications/rraporte-speciale-1/</p> <p><u>Raporti Alternativ “Mbi zbatimin e Konventës CEDAW në Shqipëri, 2016-2020”</u>, i cili përmban informacion lidhur me zbatimin e të drejtave, boshllëqeve dhe sfidave dhe adresimit të rekomandimeve drejtuar insitucioneve përgjegjëse për përmirësimin e situatës.</p> <p>Raporti evidenton aspektet kyç të situatës së të drejtave të grave në lidhje me aksesin në drejtësi dhe ndihmën juridike të garantuar nga shteti, makinerinë kombëtare për avancimin e grave, dhunën me bazë gjinore kundër grave, aksesin e grave në të drejtat ekonomike dhe sociale dhe situatën e grave në zonat rurale dhe grupet e pafavorizuara. Për secilën prej këtyre fushave, analiza vlerësuese e AP-së, përmbillet me ofrimin e rekomandimeve për përmirësimin e situatës në vitet në vazhdim.</p> <p>https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20alternative%20mbi%20zbatimin%20e%20Konventes%20CEDAW%20ne%20Shqiperi.pdf</p>	
--	--	--	---	--

			<p><u>Studimi “Dhuna ndaj grave në politikë”</u> Është një studim i cili u iniciua gjatë vitit zgjedhor 2021, duke u nisur nga problematika të tilla si përdorimi i gjuhës seksiste dhe diskriminuere gjatë fushatës zgjedhore. Studimi u krye në partneritet midis Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur me ekspertizë teknike nga UNDP në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “T” i japim fund Dhunës ndaj Grave në Shqipëri”, financuar nga Qeveria e Suedisë. Ky studim u lançua më 6 prill 2022, në një tryezë me përfaqësues nga të gjitha grupet e interesit.</p> <p>Analiza tematike identifikoi forma të ndryshme të dhunës që përjetojnë gratë: Përçmim dhe gjuhë ofenduese; ndërprerje e fjalës, tallje, fyerje, batuta; akuzat të rreme në media; kërcënime; vënie në dyshim e aftësitë të grave; heqja e grave nga listat e kandidatëve të partisë; refuzimi i aksesit në financat e partisë gjatë fushatave zgjedhore; shkarkimi ose kërcënimi për shkarkimin e grave (dhe anëtarëve të familjes së tyre) nga poste shtetërore; akuzat të rreme dhe thashetheme të natyrës seksuale; ngacmim seksual; injorimi i grave gjatë takimeve; konsiderimi i kontributit të grave si pak ose aspak i rëndësishëm; kufizimi i rolit të grave në votimin e vendimeve të paracaktuara; manipulimi i votës së grave gjatë procedurave të votimit; përjashtimi i grave nga informacioni. Për gratë, veçanërisht për gratë të cilat janë përpjekur të arrijnë pozicione drejtuese në parti – partia ku ato aderojnë është burimi kryesor i dhunës.</p> <p><i>Sugjerime dhe rekomandime</i> i janë adresuar, në përfundim të këtij studimi, partive politike, organizatave politike të grave, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, organizatave të shoqërisë civile, institucioneve të të drejtave të njeriut, mediave.</p> <p>https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/list/publications/rraporte-speciale-1/?page=2 <u>Raport mbi monitorimin e buxhetimit gjinor për adresimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në Shqipëri në vitin 2018.</u> Në kuadër të tagrit monitorues AP me mbështetjen e UNWOMEN bëri një analizë të shpenzimeve buxhetore për vitin 2018 nga ku rezultoi se fondet e alokuara për adresimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, në përgjithësi janë të pamjaftueshme dhe nuk përkojnë në një masë të konsiderueshme me nevojat reale financiare për të përmbushur angazhimet e ndërmarra në këtë fushë.</p> <p>https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/list/publications/rraporte-speciale-1/?page=4 Po ashtu gjatë vitit 2021 me mbështetjen e UNDP dhe në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, është përgatitur edhe Udhëzuesi “Për Parandalimin dhe Adresimin e Dhunës, Ngacmimit dhe Ngacmimit Seksual në Mjedisin e Punës në Institucionet e Administratës Shtetërore”</p>	
--	--	--	--	--

			<p>Qëllimi i këtij udhëzuesi është: 1. Të angazhojë institucionet e administratës shtetërore për të krijuar, garantuar dhe promovuar një mjedis të sigurtë pune duke parandaluar, reduktuar dhe eliminuar çdo formë të dhunës, ngacmimit, ngacmimit seksual dhe abuzimit me autoritetin në vendin e punës; 2. Të përcaktojë rregullat dhe procedurën/at për të parandaluar dhe adresuar dhunën, ngacmimin, ngacmimin seksual dhe abuzimin me autoritetin në vendin e punës 3. Të sigurojë për publikun mekanizmat për të adresuar dhunën, ngacmimin, ngacmimin seksual dhe abuzimin me autoritetin nga nëpunësit civilë gjatë ushtrimit të funksionit të tyre publik; 4. Të ndërgjegjësojë nëpunësit civilë në administratën shtetërore për evidentimin më të lehtë dhe më të qartë të situatave që lidhen me ngacmimin, ngacmimin seksual dhe abuzimin me autoritetin në vendin e punës si dhe me mënyrat e teknikave të ndalimit dhe parandalimit të tyre.</p> <p>Raporti “Vlerësim mbi qasjen dhe përdorimin familjar të transfertave të mbrojtjes sociale”- Vlerësimi është një nismë e Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi e mbështetur me ekspertizë teknike në kuadrin e projektit “Shtrirja e shërbimit ligjor për burrat dhe gratë në Shqipëri”, zbatuar nga PNUD Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe me mbështetjen financiare të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim- lançuar në një tryezë të rrumbullakët, më datën 27 qershor 2022.</p> <p>Vlerësimi është kryer gjatë periudhës periudhës korrik – dhjetor 2021 dhe është fokusuar kryesisht mbi viktimat e dhunës në familje si kategori e veçantë e përfituesve të Ndhmës Ekonomike (NE) dhe personat me aftësi të kufizuara. Rastet lidhur me përjashtimin apo skualifikimin për të përfituar paralelisht pagesën e ndihmës ekonomike janë referuar pranë Avokatit të Popullit nga grupe vulnerabël në përgjithësi, përfshirë viktimat e dhunës në familje.</p> <p>https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/202206/Vler%C3%ABsim%20mbi%20qasjen%20dhe%20përdorimin%20familjar%20te%20transfertave%20te%20MS.pdf</p> <p>Rekomandime:</p> <p>Disa rekomandime të AP lidhur me të drejtat e grave i gjeni në faqen zyrtare, nën Seksioni i Përgjithshëm tek zërat Gratë dhe Barazia Gjinore:</p> <p>https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/categories/general-issues/gender-equality/article</p> <p>Një pjesë e rekomandimeve të cilat kanë të bëjnë me inspektimet në Qendrat/strehëzat për gratë e dhunuara nuk janë publikuar duke iu përmbajtur ruajtjes së të dhënave sensitive. Megjithatë ndër problematikat dhe rekomandimet që adresohen kryesisht për këto qendra/strehëza mund të përmendim përmirësimin e mëtejshëm të standardeve të funksionimit, përmirësimin e infrastrukturës duke e përshtatur dhe për personat me aftësi të kufizuara, përmirësimin e</p>		
--	--	--	--	--	--

				<p>dokumentacionit, rritjen e fondeve dhe parashikimin e tyre si zë i veçantë në planet sociale të Bashkive etj.</p> <p>Ashtu siç kemi sqaruar edhe më sipër, rekomandime të tjera janë adresuar përmes studimeve dhe analizave.</p> <p>Në kuadër të mandatit të tij ligjor si promovues i të drejtave të grave dhe vajzave, Avokati i Popullit:</p> <p>Ka bërë deklaratë zyrtare në faqen zyrtare Web, mediave dhe platformës sociale FB, duke tërhequr vëmendjen e institucioneve, sidomos në rastet e dhunës në familje ose dhunës me bazë gjinore, dhe duke kërkuar të intensifikojnë përpjekjet në mënyrë të koordinuar për t'ju përgjigjur në kohë, me profesionalizëm dhe duke i mbështetur ato me shërbime të specializuara.</p> <p>Ka organizuar vetë tryeza të rrumbullakta me tematika të ndryshme, që lidhen me të drejtat e grave si dhe ka kanë qenë pjesë e tryezave dhe aktiviteteve të organizuara nga institucionet dhe shoqëria civile, në kuadër të ditës ndërkombëtare të grave më 8 Mars, 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës ndaj grave, dhe përtej këtyre ditëve. Në këto tryeza AP ka përsëritur vazhdimisht çështjet dhe rekomandimet e tij lidhur me fuqizimin e grave dhe vajzave, rritjen e buxheteve qendrore dhe vendore për të adresuar çështjet e dhunës ndaj grave, fuqizimit të strukturave sociale dhe rolit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit në bashkitë e vendit, për të garantuar mbështetjen e menjëhershme për viktimat e dhunës në familje, zbatimit të ligjit me korrektësi, përmirësimeve ligjore dhe plotësimin e boshllëqeve në legjislacion.</p> <p>Ditët e hapura të organizuara gjatë vitit, në qytete dhe rajone të ndryshme të vendit synojnë të informojnë sa më shumë qytetarë/qytetare nga të gjitha grupet përfshirë gratë e vajzat lidhur me rolin e institucionit dhe problematikat të cilat mund të adresojnë.</p>		
--	--	--	--	--	--	--